



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4880 Prot.

Roskovec, më 01, 07, 2024

V E N D I M

NR 88 .DATË 28 . 06 .2024

"PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PBA 2025-2027"

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqverisjen Vendore", në nenin 34 të ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqverisjes vendore", ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH" të ndryshuar, ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimin Nr.23 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqverisjes vendore", Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"; si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike; Këshilli i Bashkisë,

- V E N D O S I :

1. Të miratojë dokumentin e parë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Roskovec dhe 4 njësitë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave bashkëlidhur sic dhe janë ngarkuar në SMFV:
 - Raporti PBA1: Tavanet Përgatitore të PBA
 - Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
 - Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
 - Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)
 - Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - Raporti PBA6: Deklarata së Politikës së Programit
 - Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit
 - Raporti PBA8: Projektet e Investimeve

- Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin Shtojca 2,Struktura e Dokumentit të PBA Vendor 2025-2027.
 - Shtojca 2. Struktura e Dokumentit të PBA Vendor 2025-2027.
2. Ngarkohen ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2025-2027 sipas këtij dokumenti .
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Afrim Plaka

